



QENDRA KOMBËTARE  
E BIZNESIT  
Nr. 5357 Prot.  
Datë 22.2.2022

SEKRETARIA  
18 FEB 2022  
Nr. 1970 Regj Nr. 598 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT AEF SH.P.K

URDHËR

*“për vënien e sekuestros konservative”*

**Drejtuar** : Qendra Kombëtare e Biznesit  
**Për dijeni** : Kotica 2007 shpk (e përthithur nga shoqëria “Kotica” shpk me administrator Frrok Dod Kotica)  
**Për dijeni** : Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit

Pranë Zyrës së Përmbartimit Gjyqësor Privat “AEF” sh.p.k. me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbartimore me palë :

**Debitor** : Kotica 2007 shpk (e përthithur nga shoqëria “Kotica” shpk me administrator Frrok Dod Kotica).  
**Kreditor** : Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit  
**Objekt** : Pagim Gjobe

Unë Përmbartuesi Gjyqësor Emiljano A Gjoza pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbartimore,

**KONSTATOVA :**

Për titullin ekzekutiv Vendim Dënim me Gjobjë nr.213 dt.06.07.2020 në zbatim të cilit është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit Nr.1569(31134-04229-80-2021), datë 05.07.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka filluar procedura përmbartimore.

Pasi kanë kaluar afatet e parashikuara ligjore dhe debitori nuk e ka përmbushur detyrimin, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana e jonë është marrë vendimi i kalimit në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros konservative në kuotat që zotëron pala debitore : Kotica 2007 shpk (e përthithur nga shoqëria “Kotica” shpk me administrator Frrok Dod Kotica) me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.

Per kete arsye si dhe në bazë të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile,

**URDHEROJ :**

1. Qendra Kombëtare e Biznesit të vendosë masën e sekuestros konservative në kuotat që zotëron pala debitore **Shoqëria “Kotica” shpk me Nipt J97507310P (përthithëse e Shoqëria “KOTICA 2007” shpk me NIPT K78502302A** me qëllim mostjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar.
2. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.
3. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër mbahet në 4 kopje e ju njëftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja e dijenit.

Zyra e Përmbartimit Privat AEF shpk  
Përmbartuesi Gjyqësor Privat  
Emiljano A Gjoza



Zyra e Përmbartimit Privat AEF shpk Adresa: Kryqëzimi i 21 Dhjetorit, Rr. Muhamet Gjolesha, Pallati “Gora”, Kulla 1, kati.1, Tirane, Tel: +355 67 20 22 332 Web: www.aef.com.al, e-mail: info@ae.com.al, NIPT L22306011C, NR. LICENSE LN -5849-11-2012